



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 29 mars 2017, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. "Miratimin e strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe planit të veprimit". **(Vendimi nr. 28, datë 29.03.2017)**
2. "Miratimin e bilancit vjetor të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitin 2016". **(Vendimi nr. 29, datë 29.03.2017)**
3. "Miratimin e raportit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2016". **(Vendimi nr. 30, datë 29.03.2017)**
4. "Pranimin e kërkesës së shoqërisë "Media Content" sh.p.k., duke vendosur pezullimin e procedurës së rinovimit të licencës së subjektit audioviziv privat vendor "Tv A1 Report", transferimin e saj tek shoqëria "Albanian News Television" sh.p.k. dhe ndryshimin e emrit të subjektit nga "Tv A1 Report" në "Albanian News Television". **(Vendimi nr. 31, datë 29.03.2017)**
5. "Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 7, datë 19.01.2017, në masën 2, 000, 000 lekë, të vendosur ndaj shoqërisë "Tv Envo Company" sh.p.k., autorizuar për subjektin audioviziv privat kabllor "Tv Envo Company". **(Vendimi nr. 32, datë 29.03.2017)**
6. "Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 68, datë 19.12.2016, në masën 400,000 lekë, të vendosur ndaj shoqërisë "4 Plus Media Group" sh.p.k., autorizuar për subjektin audioviziv privat vendor "4 +". **(Vendimi nr. 33, datë 29.03.2017)**
7. "Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 15, datë 08.02.2017, në masën 2,000,000 lekë, të vendosur ndaj shoqërisë "Tv Kabllor Vlora Cable" sh.p.k., autorizuar për subjektin audioviziv privat kabllor "Tv Vlora Cable". **(Vendimi nr. 34, datë 29.03.2017)**
8. "Pranimin e kërkesës së shoqërisë "House of Arts Radio and Television" sh.p.k., për ndryshimin e emrit të subjektit radiofonik nga "Galaxy Radio" në "House of Arts Radio". **(Vendimi nr. 35, datë 29.03.2017)**
9. "Refuzimin e kërkesës së shoqërisë "Margit Tv" sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat vendor "Margit Tv" për zvogëlimin e zonës së licencimit dhe ripërlllogaritjen e detyrimeve financiare". **(Vendimi nr. 36, datë 29.03.2017)**
10. "Mosdhënien e autorizimit, shoqërisë "MC NETWORKING" sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet (OTT) "MCN". **(Vendimi nr. 37, datë 29.03.2017)**
11. "Rinovimin e licencës së shoqërisë "Scan" sh.a., për subjektin audio privat vendor "Radio Scan" për një periudhë 5 vjeçare dhe azhurnimin e zonës së licencimit të subjektit nga "Rrethi Tiranë-Durrës" në "Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës, Shijak". **(Vendimi nr. 38, datë 29.03.2017)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

12. "Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Sadete Jaho, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "TV kabllor Toshkëz" dhe azhurnimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga "Komuna Allkaj" në "Njësinë Administrative Allkaj". (Vendimi nr. 39, datë 29.03.2017)
13. "Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Rrahman Mekollari, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Kristal" në njësitë administrative Shirgjan dhe Qendër Librazhd, azhurnimin e zonës së ofrimit të shërbimit nga "Komuna Hotolisht, Kosovë" në "Njësinë Administrative Hotolisht, Fierzë", si dhe heqjen nga zona e ofrimit të shërbimit të subjektit "Komuna Rrushkull". (Vendimi nr. 40, datë 29.03.2017)
14. "Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 10, datë 24.01.2017, në masën 40,000 lekë, të vendosur subjektit person fizik Artur Shehu, për subjektin televiziv privat vendor "Tv Berati". (Vendimi nr. 41, datë 29.03.2017)
15. "Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Cable Net" sh.p.k., për revokimin e vendimit nr. 4, datë 19.01.2017 dhe dhënien e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Cable Net". (Vendimi nr. 42, datë 29.03.2017)

Në këtë mbledhje, AMA ra dakord që subjekteve:

- Shoqërisë "Teknomedia" sh.p.k., licencuar për operatorin televiziv privat vendor "Tv Nesër";
- Personit fizik Lulzim Spata, licencuar për operatorin televiziv privat vendor "Tv Kruja";
- Shoqërisë "Radio Albania News" sh.p.k., licencuar për operatorin radiofonik privat vendor "Albania News";
- Shoqërisë "Media Nord" sh.a., licencuar për operatorin radiofonik privat vendor "Radio Grant";
- Personit fizik Eno Alimerko, licencuar për operatorin radiofonik privat vendor "Radio Ime";
- Shoqërisë "Radio +3" sh.p.k., licencuar për operatorin radiofonik privat vendor "Radio +3";

T'u përsëritet njoftimi për shlyerjen e detyrimeve financiare, ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit dhe për depozitimin e aplikimit për rinovimin e licencës, duke iu bërë me dije se në rast se nuk merren masa për sa më sipër, AMA në mbledhjen e radhës do të procedojë me vendimmarrjen për konstatim të pavlefshmërisë së licencës së këtyre subjekteve.

Po ashtu, AMA ra dakord të marrë në shqyrtim në mbledhjen e ardhshme ankimet administrative ndaj:

- Vendimit me gjobë të vendosur nga Grupi i Inspektimit/ose AMA ndaj shoqërisë "Arlibon" sh.p.k., autorizuar për subjektin "Tv Kabllor Fieri". (Vendimi Nr. 1, datë 16.01.2017).
- Vendimit me gjobë të vendosur nga Grupi i Inspektimit/ose AMA ndaj shoqërisë "Arlibon" sh.p.k., autorizuar për subjektin "Tv Kabllor Fieri". (Vendimi Nr. 14, datë 01.02.2017).
- Vendimit me gjobë të vendosur nga Grupi i Inspektimit/ose AMA ndaj shoqërisë "Arlibon" sh.p.k., autorizuar për subjektin "Tv Kabllor Fieri". (Vendimi Nr. 16, datë 08.02.2017).
- Vendimit me gjobë të vendosur nga Grupi i Inspektimit/ose AMA ndaj shoqërisë "Tring Tv" sh.a, autorizuar për platformën numerike "Tring Tv". (Vendimi Nr. 67, datë 19.12.2016).

Tiranë, 31 mars 2017

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE